



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:274729
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05652412

AC.nr.6435/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Liridon Maloku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Gjykata Themelore në Mitrovicë, kundër debitorit M.S , lidhur me çështjen përmbarimore për pagesën e shpenzimeve të procedurës, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, CP.nr.902/21 të datës 09/02/2022, me datën 03.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e debitorit M.S, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, CP.nr.902/21 të datës 09/02/2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, CP.nr.902/21 të datës 09/02/2022, ka vendosur si vijon: REFUZOHET në tërësi si i pabazuar kundërshtimi i debitorit M.S ashtu që VËRTETOHET aktvendimi për lejimin e përmbarimit CP.nr.902/21 e datës 07/12/2021.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe kontestimore, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e debitorit, ta anulojë aktvendimin dhe çështjen ta kthejë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kreditori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 02.12.2021, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit kundër debitorit M.S, ndërsa Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin

CP.nr.902/21 e datës 07/12/2021, e ka lejuar përbarimin e propozuar në bazë të dokumentit përbarimor-aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.979/18 i datës 28/06/2019, i cili është i plotfuqishëm me datën 05/08/2019.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin ankimor e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit dhe e ka vërtetuar aktvendimin përbarimor duke u bazuar në nenin 43 par.4, e lidhur me nenin 71 dhe 73 të LPP-së dhe mes tjerash ka theksuar se dokumenti përbarimor është në tërësi i përshtatshëm për përbarim pasi që në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit, siç është afati prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, që nënkupton se në rastin konkret janë respektuar edhe kushtet ligjore të parapara me dispozitat e LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit i pa themeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përbarimore, ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim, në bazë të dokumentit përbarimor si në dispozitën e nenit 21 dhe nenin 22 të Ligjit për Procedurën Përbarimore. Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim, në bazë të dokumentit përbarues, organi përbarues me të drejt e cakton përbarimin vetëm në bazë të titullit përbarues sipas dispozitës së nenit 22, paragrafi 1, pika 1.1 të LPP-së, si dokument përbarues është: “vendimi përbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përbaruese”. Në rastin konkret titull përbarues është aktgjykimit Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.979/18 i datës 28/06/2019, i cili është i plotfuqishëm me datën 05/08/2019. Dokument përbarues në bazë të nenit 23 paragrafi 1, të LPP-së është përcaktuar se: “vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me vendim përbarues të gjykatës siç përcaktohet me dispozita ligjore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përbarimore “*në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual*”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (b) të LPK, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

Numri i lëndës: 2021:274729
Datë: 03.05.2024
Numri i dokumentit: 05652412

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
AC.nr.6435/2022, me datë 03.05.2024

Gj y q t a r i
Liridon Maloku